

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE

SHPALLJE PER VENDE TE LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, date 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a. Vendimin Nr.11. datë 06.06.2024 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a”, Vendimit nr.9 date 18.12.2025, “Keshillit Mbikqyres”, Për miratimin e organigramës dhe nivelit te pagave për punonjësit e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a, shpallen procedurat e konkurimit per vend te lire pune:

1(nje) Pergjegjies Puke

Detyrat dhe pergjegjesite kryesore

Ka varësi direkte nga Drejtori i prodhimit dhe transmetimit të ujit.

1. Përgjigjet përpara Administratorit , Drejtorit Teknik dhe Drejtorit te sektorit
2. Ndjek dhe zbaton grafikët e personelit të turneve nëpër stacione e depo.
3. Bën kujtesën e sigurimit teknik sipas afateve të miratuar nga Inspektoriati i Punës .
4. Harton grafikët për mirëmbajtjen dhe riparime të pompave dhe të saracineskave në stacione e depo.
5. Zbaton klorinimin dhe sasinë e klorit të urdhëruar nga sektori.
6. Harton kërkesat materiale për këto riparime dhe ia paraqet Drejtorit të sektorit.
7. Harton grafikët për punët e pompave.
8. Është personi përgjegjës për manovrimet në pusetat kryesore të rrjetit kryesore dhe shpërndarës, në stacione dhe rezervuare
9. Ndhmon të planifikojë lejet e zakonshme të punonjësve duke marrë në konsideratë dhe kërkesat e tyre.
10. Kontrollon gjatë gjithë kohës punën nëpër stacione e depo.
11. Merr masa për mos ndërprerje të prodhimit pa urdhër të shoqërisë.
12. Detyrohet të ketë njohje të mirë të të gjitha skemave teknologjike dhe elektrike të stacioneve dhe depove.
13. Harton masat e mirëmbajtjes së objekteve dhe të zonave të rreptësisë.

14. Detyrohet të japë zgjidhjen e duhur problemeve me pompat dhe të gjitha paisjet e tjera në stacione.
15. Është direkt personi përgjegjës për rastet e ndërhyrjes pa leje me lidhje në rrjetin elektrik që furnizon këto objekte
16. Është përgjegjës për gatishmërinë dhe për prezencën në objektet e depove të ujit të mjeteve e pajisjeve mbrojtëse emergjente sipas RRST për ndërhyrje e mbrojtje në raste zjarri, shkarkesa elektrike atmosferike, avari në sistemet dhe impiantet elektrike të instaluar në depot e ujit, defekte të rënda në rrjetin e furnizimit me energji elektrike nga linjat e TM, kontakte me rrezikshmëri të lartë rryme elektrike etj.
17. Vendos në objektet e depove të ujit tabelat me mbishkrimet e RRST në vendet e punës dhe realizon instruktimin periodik të personelit me këtë rregullore.
18. Bën tërheqjen e materialeve nga magazina, pas autorizimit nga eprori respektiv, për materialet për konsum për sektorin që mbulon.
19. Mban përgjegjësi për instruktimin e punonjësve në afatet e caktuar të rregullave të sigurimit teknik.
20. Mban përgjegjësi për mosinstruktimin e punonjësve të rinj me skemat e funksionimit të stacioneve dhe rregullave të sigurimit teknik.
21. Mban përgjegjësi për mos zbatimin e disiplinës në punë .
22. Për mosraportimin në kohë të defekteve të konstatuara.
23. Për moszbatim të urdhërave të dhënë nga eprorët

Kandidatet duhet të plotesojnë kerkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Te jene shtetas shqiptare .
- ✓ Arsim I mesem ose I larte .
- ✓ Te jene ne gjendje te mire shendetesore dhe te afte fizikisht.

DOKUMENTACIONI , MENYRA DHE AFATET E DOREZIMIT

1. CV
2. Fotokopje ID
3. Librezë Pune
4. Çertifikatë personale
5. Çertifikatë e gjendjes familjare
6. Diplome shkolle (e noterizuar)
7. Listë notash (e noterizuar)
8. Çertifikatë/ Dokument për kualifikime të ndryshme/Specializime
9. Dëshmi Penaliteti
10. Vertetim i Gjendjes Gjyqësore
11. Vertetim prokurorie
12. Saktësim adrese nga Bashkia
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë)
14. Foto të vogla (2 copë), foto e madhe (1 copë)

Afati i aplikimit 10 dite.

Kandidatet do te vleresohen ne lidhje me dokumentacionin e dorezuar.

Ne perfundim te vleresimit te kandidateve , Drejtoria e Burimeve Njerezore do te shpalle fituesit ne portalin “ Sherbimi Kombetar I Punesimit”, ne faqen e internetit.

Kandidatet jo fitues kane te drejte te ankimohen prane Drejtorise se Burimeve Njerezore . Afati I Ankimit eshte 3 (tre) dite nga data e shpalljes se fituesit.

